

URDHËR
Nr. 439, datë 23.4.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË ENCEFALOPATISË
SPONGIFORME TË GJEDHIT (BSE), TË SHFAQUR NË SHTETIN E IRLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) kafshëve të gjalla të llojit gjedh;
- b) mishit të freskët dhe produkteve të mishit;
- c) miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, që kanë origjinë nga një vend, zonë apo ndarje (kompartiment) që paraqet rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) ose rrezik të papërcaktuar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE);
- ç) gjakut dhe produkteve të gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh;
- d) dhjamt të shkrirë dhe derivatet e dhjamt;
- dh) dikalciumit fosfatit;
- e) ileumit distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, që kanë origjinë nga një vend, zonë apo ndarje (kompartiment) që paraqet rrezik të papërcaktuar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), nëse këto produkte rrjedhin nga gjedhë të lindur përpara datës nga e cila është provuar se rreziku i riciklimit të agjentit të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) në popullatën e gjedhit është bërë i papërfillshëm;
- ë) ushqimit, ushqimit për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisjet mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura, duke përdorur materialet e përmendura në shkronjën “e” të kësaj pike.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), të shfaqur në shtetin e Irlandës janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1
1.	Kilkenny*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të shtetit të Irlandës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit gjedh:
 - i. të përzgjedhur për eksport janë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve që mundëson gjurmimin e tyre gjatë të gjithë jetës së tyre; dhe/ose
 - ii. të përzgjedhur për eksport kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm ose të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhëve është treguar i papërfillshëm; ose
 - iii. të përzgjedhur për eksport, janë provuar se nuk janë ushqyer kurrë me miell proteinik të nxjerrë nga kafshët ripërtypëse;
- b) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton, që:
 - i. kafshët e llojit gjedh nga i cili është nxjerrë mishi dhe produktet e mishit të freskët të jenë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve;

ii. kafshët e llojit gjedh i janë nënshtruar një inspektimi *ante mortem* me rezultate të favorshme;

iii. kafshët e llojit gjedh kanë lindur dhe janë mbajtur, në:

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm; ose

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) para datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm, dhe mishit dhe produkteve të mishit të freskët janë nxjerrë nga gjedhë që nuk i janë nënshtruar një procesi trulllosjeje me një pajisje që injekton ajër të kompresuar ose gaz në zgavrën e kafkës, ose një procesi të pastrimit të palcës, ose ndonjë procedure tjetër që mund të kontaminojë gjakun me ind nervor, para therjes; dhe

- janë prodhuar dhe trajtuar në një mënyrë që siguron që produkte të tilla nuk përmbajnë dhe nuk janë të kontaminuara me mallrat e listuara në pikën 1, të nenit 11.4.15, të Kodit Tokësor të WOAH ose mish i ndarë mekanikisht nga kafka, ose nga kolona vertebrale e gjedhit mbi 30 muajsh;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që:

i. kafshët e llojit gjedh nga të cilët është nxjerrë mielli proteinik janë identifikuar nëpërmjet një sistemi identifikimi të kafshëve dhe kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); dhe/ose

ii. kanë lindur pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhëve është treguar i papërfillshëm; ose

iii. mielli proteinik është përpunuar në përputhje me nenin 11.4.19 të Kodit Tokësor të WOAH përkatësisht:

- lënda e parë duhet të reduktohet në një madhësi maksimale grimcash prej 50 mm përpara ngrohjes dhe duhet të ngrohet në kushte avulli të ngopur në një temperaturë jo më të ulët se 133°C për një kohë minimale prej 20 minutash, në një presion absolut prej 3 bar; ose

- një procedurë alternative që është provuar se arrin të paktën një nivel të barasvlershëm reduktimi të infektivitetit të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE);

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që gjaku dhe produktet e gjakut, janë:

i. nxjerrë nga gjedhë që janë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve dhe kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm ose në një vend, zonë, ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm; ose

ii. mbledhur nga gjedhë që nuk i janë nënshtruar një procesi trulllosjeje me një pajisje që injekton ajër të kompresuar ose gaz në zgavrën e kafkës, ose një procesi të pastrimit të palcës, ose ndonjë procedure tjetër që mund të kontaminojë gjakun me ind nervor, para therjes; dhe

iii. mbledhur dhe përpunuar në një mënyrë që siguron që ato të mos kontaminohen me ind nervor;

d) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që dhjami i shkrirë:

i. vjen nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii. rrjedh nga kafshë të llojit gjedhë që i janë nënshtruar një inspektimi *ante mortem* me rezultate të favorshme dhe nuk është përgatitur, duke përdorur mallrat e listuara në pikën 1, të nenit 11.4.15 të Kodit Tokësor të WOAH;

dh) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që derivatet e dhjemit:

i. e kanë origjinën nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii. nxirren nga dhjami që plotëson kushtet e përmendura në nenin 11.4.16 të Kodit Tokësor të WOAH; ose

iii. janë prodhuar nga hidroliza, saponifikimi ose transesterifikimi që përdor temperaturë dhe presion të lartë;

e) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që dikalcium fosfati:

i. vjen nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii. është një bashkëprodukt i xhelatinës së kockave.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit gjedh, mishit të freskët dhe produkteve të mishit, miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh, dhjamt të shkrirë dhe derivatet e dhjamt, dikalcium fosfatit, ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të çdo ngarkese të kafshëve të gjalla të llojit gjedh, mishit të freskët dhe produkteve të mishit, miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh, dhjamt të shkrirë dhe derivatet e dhjamt, dikalcium fosfatit, ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUIQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri